



Komunikatë 'Çfarë ndodh në të vërtet tek Shërbimi Psikologjik Shkollor?'

Një regjistrim tek shërbimi psikologjik shkollor, shpesh i çliron nga frika jo vetëm fëmijët por edhe prindërit e tyre. Ja para disa këshilla që ju dhe fëmija e juaj mund ti kini parasysh gjatë vizitës së juaj tek ne.

Pse tek SHPSH-ja?

I shpjegoni fëmijës tuaj qetë dhe qartë, pse ju apo mësimdhënësi keni vendosur ta merrni në konsideratë ndihmën psikologjike shkollore. Pranimi i ndihmës psikologjike shkollore nuk është ndonjë dobësi dhe nuk le asnjë gjurmë negative tek personeli i trajnuar (Mësuesit, Pedagoget kuruese, Logopedët, etj.), përkundrazi.

Mos i mashtroni fëmijët tuaj, mos iu tregoni fantazira. Fëmijët e vërejnë menjëherë nëse dikush provon ti mashtroj, apo nëse mundoheni ti u shmangeni (vononi) diskutimeve të drejtpërdrejta (ndershme). Bisedoni shtruar për probleme, dhe bëjani të qartë fëmijut që në këtë moment as ju e as mësimdhënësi nuk mund ta zgjidhin këtë problem, prandaj edhe keni nevojë për një këshillë nga pala e tretë. Mos e zvogëloni problemin por cilësoni atë si një gjë reale. Problemet shkollore janë të zakonshme, prandaj edhe pranimi i ndihmës për zgjidhjen e tyre është gjithashtu i zakonshëm.

Çfarë është SHPSH-ja dhe çfarë ndodh atje?

Vërtet, ne quhemi psikolog shkollor, por ne nuk jemi shkollë. Nuk japim nota, prandaj tek ne ju bile mund ta fyeri (shani) shkollën. Ne do të luajmë me fëmijun tuaj, por ne gjithashtu do kërkojmë edhe rezultate. Mirëpo, këto rezultate nuk do të jenë si ato të shkollës. Ne bisedojmë me fëmijë jo me anë të testeve, por me anë të enigmave dhe detyrave. Fëmijët kanë shumë dëshirë ti zgjedhin enigmat, për atë arsye edhe janë shumë të motivuar për të marr pjesë në sqarimet tona psikologjike. Ju lutëm që edhe ju në shtëpi të provoni ti shmangeni fjalës `Test`.

Ne kërkojmë mjaftë nga fëmiju juaj. Megjithatë, shumica e fëmijëve kanë kujtime të mira nga sqarimet tona psikologjike, dhe shumica bile do të kishin dëshirë të vinin prapë këtu. E kjo ka të bëjë me atë që tek ne fëmiju juaj e shijon jetën e një të rrituri me përkujdesje të plotë, gjë që asnjëherë nuk ndodh nëpër shkolla.

Nëse fëmiju juaj nuk dëshiron që të qëndron i vetmuar, ne do të përpiqemi shumë që ai (ajo) ta ndjen vetën mirë tek ne. Ju mund të qëndroni me fëmijun e juaj në fillim të kontrollimit (hulumtimit), deri në atë moment kur ai (ajo) do jetë në gjendje të qëndroj i vetmuar tek ne. Mirëpo gjatë testimit nuk do ishte mirë që prindërit të jenë prezent, pasi që prezenca e tyre ose do i dekoncentronte fëmijët ose do i shtynte ata që të tregohen të aftë para prindërve. E kjo gjë shkakton stres, gjë që mund të ndikonte negativisht në aftësitë e tyre.

Çfarë vlen tjetër që duhet marr parasysh?

- Nëse fëmiju i juaj mban syza, ai (ajo) do duhej ti mbante ato edhe gjatë kontrollimit (vizitës).
- Kontrollimi (hulumtimi) nuk mbahet me fëmijë të sëmur. Nëse sëmuret fëmiju juaj ju lutëm, anuloni terminin, në rast nevojë edhe për një kohë të shkurtër.
- Ngjarjet sociale me rëndësi siç janë ekskursioni shkollor apo kremtimi i ditëlindjes janë gjithashtu shkak për anulim të terminit. Megjithatë, ju lutëm, na lajmëroni me kohë.
- Ju jeni një shembull me rëndësi për fëmijun tuaj. Proveni që përballë sqarimit psikologjik ti shikoni gjërat pozitivisht dhe të jeni zemërhapur. Atëherë edhe fëmiju i juaj nuk do të jetë me ndjenja negative gjatë kontrollimit (hulumtimit).

Jeni të mirëseardhur. Do të ishim shumë të kënaqur të ju takojmë juve dhe fëmijun tuaj.